

Në bazë të konkluzave, rekomandimeve dhe masave, nga mbledhja e 17-të e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut mbajtur më 12 mars 2020 , pika 18 alineja e dytë dhe e tretë, dhe konkluzave, rekomandimeve dhe masave, nga mbledhja e 26-të e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut mbajtur më 23 mars 2020, në lidhje me parandalimin e paraqitjes dhe përhapjes së Koronavirusit COVID-19, në të cilën është miratuar Dekret me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim fillor për realizimin dhe organizimin e mësimit në shkollat fillore, si dhe për mënyrën e vlerësimit të nxënësve gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.766/2020) dhe Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për shkollim të mesëm për realizimin dhe organizimin e mësimit në shkollat fillore, si dhe për mënyrën e vlerësimit të nxënësëve gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.766/2020), Byroja e zhvillimit të arsimit në bashkëpunim me Qendrën për arsim profesional dhe trajnime përpiloi

UDHËZIM PËR MËSIMDHËNËSIT PËR MËNYRËN E VLERËSIMIT TË NXËNËSVE NË PERIUDHËN E REALIZIMIT TË MËSIMIT PËRMES MËSIMIT NË DISTANCË KRYESISHT MËSIMI NGA SHTËPIA

Vlerësimi i nxënësve është i rregulluar me Ligjin për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 161/19) dhe Ligjin për arsim të mesëm, („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18), si dhe me akte nënligjore.

Në pajtim me nenin 138 të Ligjit për arsim fillor „Arritjet e nxënësve në arsimin fillor vlerësohen në mënyrë formative dhe përbledhëse si dhe shënohen me nota

përshkruese dhe/ose me nota numerike". Në nenin e njëjtë mëtej, përcaktohet mënyra e të shënuarit të arritjeve të nxënësit për secilën periudhë (prej klasës I deri në klasën III, prej klasës IV deri në klasën VI dhe prej klasës VII deri në klasën XI). Përderisa për arsimin e mesëm në pajtim me nenin 45 të Ligjit për arsim të mesëm „(1) Përcjellja dhe vlerësimi i përparimit dhe arritjeve të suksesit të nxënësve bëhet me vlerësim intern. (2) Vlerësimin intern të arritjes së suksesit të nxënësve e bëjnë mësimdhënësit në shkollë". Në pajtim me dekretet e theksuara më lartë të miratuara në mbledhjen e 26- të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nenet e caktuara të Ligjit duhet të respektohen edhe në kushtet e ndryshme të realizimit të mësimit (përmes mësimit në distancë kryesisht mësimit nga shtëpia).

Planifikimi i mësimit në kushte të realizimit të mësimit në distancë kryesisht mësimit nga shtëpia

Planifikimi, organizimi dhe realizimi i mësimit nga ana e mësimdhënësve, kur mësimi realizohet nga ana e mësimdhënësve, kur mësimi realizohet përmes mësimit në distancë, përkatësisht mësimi nga shtëpia duhet përshtatur dhe të realizohet në mënyrën që do të mundësojë arritje të rezultateve të pritura nga ana e nxënësve në pajtim me programet mësimore.

Planifikimi i mësimit, njëjtë si dhe gjatë realizimit të mësimit në shkollë fillore, përkatësisht në shkollën e mesme, bazohet në planet mësimore dhe programet mësimore për arsimin fillor dhe të mesëm të përpiluara nga Byroja e zhvillimit të arsimit si dhe planet dhe programet mësimore për të gjithë llojet e arsimit profesional për lëndët profesionale – teorike dhe mësimin praktik të përpiluara nga Qendra për arsim të mesëm profesional dhe trajnime. Realizimi i mësimit përmes mësimit në distancë, përkatësisht nga shtëpia, nënkupton modifikim të planifikimit (veçanërisht planifikimin ditor / tematik / precesues -zhvillimor, afatmesëm dhe planifikimin ditor,

kryesisht planifikimin e njësive moduluese dhe planifikimin e orës mësimore) në pjesën e mënyrës së realizimit të mësimit me shfrytëzimin e qasjes, metodave dhe teknikave adekuate për këtë lloj të mësimit, ndërsa në pajtim me mundësitë që i ofron platforma elektronike që përdoret (sipas mundësive të krijuara nga shkolla, pushteti lokal dhe/edhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës), si dhe në mënyrën e përcjelljes, vlerësimin dhe arritjet e nxënësve.

Mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme duhet ta përshtatin praktikën e përditshme, të bëjnë punë plotësuese, të bashkëpunojnë me kolegët, prindërit/tutorët dhe gjithashtu të mbajnë përgjegjësi për punën individuale. Nga aspekti i planifikimit të mësimit në distancë, që realizohet online ose me ndihmën e TIK pa prezencën e nxënësve në hapësirë të njëjtë, mësimdhënësit bëjnë përshtatje të ndryshme në pjesën e aktivitetetave, formave, metodave të punës dhe resurset që duhet të jenë në përputhje për mësimin përmes mësimit në distancë, kryesisht mësimit nga shtëpia, si dhe komunikimi me nxënësit, kryesisht përshtatja e mënyrës së realizimit të orës (inçizim, animim dhe video, krijim të prezantimit, parashtrim i testit, onlin komunikimi me nxënësit), udhëzimi i nxënësve në shembuj të TV klasës, në ligjerata të inçizuara (www.eduino.gov.mk), udhëzimi i nxënësve në softuerë të caktuar edukativ, letrat dhe mjetet tjera adekuate për arritjen e qëllimeve konkrete, shfrytëzimi i mjetetave digitale për interaksion dhe përpilimi i detyrave visuale, të animuara, kuize, të zhvilluarit e detyrave projektuese, zgjidhja e situatave problematike etj. Madje, duhet theksuar se të gjitha aktivitetet planifikohen në përputhje me qëllimet e definuara dhe rezultatet e pritura në programet mësimore.

Përcjellja e arritjeve të nxënësve, vlerësimi i arritjeve të nxënësve si pjesë e planifikimit të mësimit nga ana e mësimdhënësve, gjithashtu duhet të jetë e planifikuar dhe e përshtatur në kushte të realizimit të mësimit në distancë.

Vlerësimi (formativ dhe përbledhës) i nxënësve në kushte të mësimit në distancë përkatësisht mësimit nga shtëpia

Vlerësimi si komponentë e rëndësishme e mësimit (së bashku me nxënien e mësimdhënësve dhe nxënien e nxënësve) gjatë realizimit të mësimit me shfrytëzimin e qasjeve bashkëkohore që i ofron zhvillimin e teknologjisë informatike (platforma, rrjeti elektronik, mediat elektronike) gjitashtu, nënkopon përdorimin e përcjelljes formative të përparimit të nxënësve dhe vlerësimin përbledhës të arritjeve të nxënësve.

Vlerësimi formativ zbatohet vazhdimesht në procesin e nxënies kur nxënësit duhet të demonstrojnë shkallë të caktuar të arritjeve të rezultateve të pritura. Mësimdhënësit i shënojnë rezultatet nga vlerësimi formativ. Sigurohen informata të caktuara për nxënësit që ka të bëjë me atë se vallë janë arritur rezultatat e pritura të parashtruara dhe me të cilat diagnostifikohen vështirësitet themelore në procesin e nxënies. Mësimdhënësit mbikëqyrin si dhe në çfarë vëllimi nxënësit e kanë arritur të planifikuarën, marrin informata për vështirësitet që i kanë nxënësit në përvetësimin e përbajtjeve dhe në bazë të atyre mbikëqyrjeve ju jasin udhëzime plotësuese dhe këshilla përmes aktiviteteve plotësuese që ju nevojiten nxënësve për arritjen e rezultateve të pritura. Vlerësimi formativ formal e lehtëson procesin e mësimit dhe shfrytëzohet për përshtatjen e mësimit, nxënies dhe vlerësimit në të arrdhmen.

Vlerësimi formativ, siç është i njohur, kërkon interaksion më të madh ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënëse, përderisa në kushte të realizimit të mësimit përmes mësimit në distancë kryesisht mësimit nga shtëpia, interaksi arrihet përmes rrjetëve elektronik dhe platformave. Kjo nënkopon se për përcjelljen, vlerësimin e përparimit të nxënësve me rëndësi është të ekzistojë komunikim i rregullt ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve, meqë kjo ju mundëson mësimdhënësve të mbledhin aq sa munden më tepër informata për atë se si nxënësit mësojnë dhe se sa e kanë përvetësuar

materialin/njësitë mësimore për lëndën konkrete mësimore. Që të profunkcionojë vlerësimi formativ nevojitet që mësimdhënësit t'i shfrytëzojnë qasjet e lartëpermendura, format dhe metodat e punës që do të mundësojnë nxënësit të hulumtojnë, parashtronjë qëllime, të bashkëpunojnë ndërmjet veti me nxënësit tjerë, të komunikojnë, të mendojnë në situata reale e situata jetësore. Llojet e përcjelljes dhe vlerësimi i rezultateve nga mësimi me shfrytëzimin e metodave të theksuara të punës shpesh herë janë: vlerësimi nga ana e mësimdhënësve, vetëvlerësimi, vlerësimi nga moshatarët, e – portfolio.

Ekzistojnë një numër i metodave dhe teknikave adekuate për vlerësimin formativ të përparimit të nxënësve me përdorimin e platformave dhe rrjeteve elektronike. Kjo përfshin detyra siç janë:

- Pyetje ese (përdorimi i postës elektronike),
- Përpunimi i projekteve (përmes punës në grupe),
- Debate në Skajp ose në Viber (ose debate përmes platformave dhe rrjeteve tjera),
- Prezantime multimediale,
- Përgatitja e postereve (përmes punës në grupe),
- Projekte/Detyra hulumtuese (përmes punës në grupe),
- Teste të njojurive (mund të ndiqen përmes rrjeteve sociale, postës elektronike ose përmes platformës),
- Ushtrime kontrolluese të nxënësve (mund të ndiqen përmes platformës elektronike, rrjeteve sociale, postës elektronike e të tjera),
- Portfolio elektronike e nxënësit.

Për përdorimin e metodës së testimit, mësimdhënësit mund të shfrytëzojnë pyetësor dhe kuizin si mjet për të përpiluar teste për testim me detyra dhe pyetje me zgjedhje të shumëfishtë, pyetje të hapura, pyetje me plotësim dhe përgjigje të shkurtra dhe

përmes shfrytëzimit të mjeteve të ndryshme për shpërndarjen e materialeve, siç janë: Google Forms, OneNote, Linolt, Padlet, Zoom, Kahoot, Mentimeter, Socrative, Microsoft Teams, SurveyMonkey, Quizlet, Edmondo, ClassDojo, Zëri im etj, përkatësisht përmes mjeteve që kanë qasje, i kanë të njohura dhe mund t'i përdorin edhe mësimdhënësit edhe nxënësit. Detyrat dhe pyetjet për testim të përpilohen në pajtim me programet mësimore. Gjithashtu, testet duhet të janë voluminoze, përkatësisht rekomandohet të përmbajnë së paku dhjetë pyetje ose detyra thelbësore.

Njëra nga mënyrat e vlerësimit formativ në kushte të mësimit në distancë është udhëheqja e portfolios elektronike (e-portfolio) për secilin nxënës. Portfolio elektronike paraqet përbledhjen e punimeve, përpunimet që i tregojnë rezultatet e arritura të nxënësit konkret përmes aktiviteteve të ndryshme në procesin mësimor në këtë periudhë të mësimit vjetor (për shembull: çek listë, intervistë, detyra me shkrim, pasqyra e detyrave kontrolluese, teste, përpunime, vizatime postera, albume, konklaza nga hulumtimet dhe aktivitetet e realizuara, incizime të dëshmive për krijimtarinë gojore dhe muzikore, propozime të regjistruar për zgjidhjen e problematikës konkrete, informata të shkruara kthyese nga nxënësit dhe ngjashëm, të cilat janë karakteristike për përparimin dhe të arriturat e tij, si dhe dëshmitë për vetëvlerësim e xënësit).

Ekzistojnë mjetë të ndryshme që kanë qasje në internet (për shembull: <https://www.mentimeter.com/> - krijimi i kuizit dhe grumbullimi i rezultateve në dosje, <https://socrative.com/> etj), dhe të cilat mundësojnë ndjekje të lehtë e të arriturave të nxënësve (kuize, krijimi i testeve me pyetje me zgjidhje të shumëfishtë, dhënia e mendimit nga nxënësit etj.) që mund t'iu ndihmojnë mësimdhënësve në krijimin dhe plotësimin e portfolios elektronike për secilin nxënës.

Për nxënësit e mësimit klasor në shkollën fillore, mësimdhënësi në bashkëpunim me prindërit e nxënësve në portfolion elektronike të secilit nxënës të paraleles së tij do të paraqesë dëshmi të ndryshme për të arriturat e nxënësit konkret, si për shembull:

(fotografi/inçizime të vizatimeve, rrumbullakimi i shkronjave të mëdha të shtypit në revistën për fëmijë që e ka në shtëpi, fotografi/inçizime të vizatimit të personazhit kryesor të tregimit që nxënësi e ka dëgjuar, vizatim që paraqet përfundimin e fillimit të tregimit, i menduar nga nxënësi, video ose audio inçizim i tregimit, gjëegjëzën që e ka menduar nxënësi, videoinçizim i dramatizimit, luajtja e rolit konkret nga nxënësi, audio/video inçizim e recitimit të poezisë së mësuar, fotografia e ilustrimeve të radhitura sipas asaj se si është zhvilluar ngjarja në tregimin e dëgjuar, grupimi i lëndëve në bazë të detyrës së dhënë dhe bashkëngjëjtja ose shënim i shifrës përkatëse, paraqitja e formave 2D dhe 3D që i ka nxënësi në shtëpi, përpunimi i piktogramit, vizatimi i pjesëve të bimës, fotografi të luleve të përpunuara në teknikën origami, të mjeteve të përpunuara të trafikut nga brumi ose nga kutia dhe ngjashëm).

Gjatë fotografimit, inçizimit të zërit dhe videos ku paraqiten nxënësit, mësimdhënësit duhet veçanërisht të kenë kujdes që t'i mbrojnë të dhënat e mara dhe të njëjtat t'i shfrytëzojnë kryesisht për ndjekjen e të arriturave të nxënësve, duke pasur parasysh dispozitat ligjore në Ligjin për mbrojtjen e të dhënavë personale.

Prindërit/tutorët e nxënësve mund t'iu dërgojnë mësimdhënësve komentet e tyre për atë se vallë nxënësi/nxënësja ka punuar në mënyrë të pavarur, si ka qenë interesimi për realizimin e detyrës së marrë, vallë kanë hasur në paqartësi etj. Mësimdhënësi iu dërgon informata kthyese prindërve/tutorëve të nxënësve për shqyrtimet e tyre që kanë të bëjnë me dëshmitë e analizuara për të arriturat e nxënësve.

Me nxënësit e mësimit lëndor, në veçanti me nxënësit e shkollave të mesme, mësimdhënësi realizon komunikim të drejtpërdrejtë e të sigurtë përmes platformave elektronike dhe rrjeteve ku e ndjek punën e tyre. Në ndjekjen dhe kontrollimin e të arriturave, në veçanti për formimin e notës, i merr parasysh të gjitha aktivitetet, përkatësisht pjesëmarrjen në diskutime, përgjigjet e detyrave, pyetjeve të parashtruara, detyrave të shtëpisë të dhëna përmes postës elektronike, pjesëmarrjes dhe përpunimit

të projekteve (të punuara në mënyrë individuale ose në ekip), përgjigjet e ushtrimeve të kontrolluara dhe testeve që pasojnë përmes postës elektronike etj.

Për nxënësit e arsimit profesional, gjatë vlerësimit të ushtrimeve dhe mësimit praktik, mësimdhënësi jep temë për përpunimin e detyrës projektuese. Mësimdhënësi më pas nxënësit i udhëzon në video materiale me procese ose shërbime të treguara teknologjike, në bazë të programit mësimor, të cilat do të analizohen përmes përpilimit të detyrës projektuese. Për formimin e notave të mësimit praktik dhe ushtrimeve, si mjet kryesor do të përdoret dosja e njohurive të fituara dhe shkathtësive për nxënësin. Dosja për të arriturat e njohurive dhe shkathtësive të nxënësit do të udhëhiqet si portfolio elektronike me komunikim të vazhdueshëm ndërmjet nxënësit dhe mësimdhënësit për ndjekjen e të arriturave të nxënësit dhe për një imazh të qartë të nxënësit për rezultatet që i ka realizuar.

Të gjitha informatat dhe materialet e fituara nga nxënësit i shfrytëzon vetëm mësimdhënësi, kryesisht për ndjekjen e procesit edukativo-arsimor dhe për vlerësimin e të arriturave të nxënësve.

Nëqoftëse situata nuk do të mundësojë që nxënësit të kthehen në klasa deri në fund të vitit mësimor vijues, notat përfundimtare sumative do të bazohen në rezultatet që i kanë arritur nxënësit gjatë vitit mësimor, përmes mësimit të rregullt, si dhe përmes pjesëmarrjes aktive në platformat dhe rrjetet online, portfolios elektronike ose përmes mjeteve tjera të punimeve të nxënësve, shënimëve të mbajtura nga mësimdhënësit të cilat mund të merren përmes llojeve të ndryshme të këmbimeve të punimeve (detyrave të shtëpisë, ushtrimeve dhe kontrollimeve, eseve, projekteve, prezantimeve, vizatimeve, ilustrimeve etj.), që nxënësit, siç u theksua më lartë mund t'ua sigurojnë mësimdhënësve përmes postës elektronike ose në kuadër të rrjetit të platformës së zgjedhur.

Të gjitha notat formative dhe shqyrtimet e mësimdhënësit gjatë realizimit të mësimit online do të përdoren për formimin e notës sumative për tremujorshin e tretë të secilit nxënës në paralele. Notat e tremujorshit të tretë (vlerësimet përshkruese për nxënësit prej klasës I deri në klasën VI dhe notat numerike për nxënësit prej klasës VII deri në klasën IX) mësimdhënësi i shënon në Fletën evidentuese (publikuar në ueb faqen e Byrosë së zhvillimit të arsimit).

Notat nga tremujorshi i parë, gjysmëvjetori i parë dhe tremujorshi i tretë mësimdhënësi i shfrytëzon për ta formuar notën në fund të vitit mësimor (vlerësimi përshkrues për nxënësit prej klasës I deri në klasën e III dhe nota numerike për nxënësit prej klasës IV deri në klasë IX).

Mësimdhënësit në arsimin e mesëm, gjithashtu notën në fund të vitit mësimor do ta formojnë nga notat e tremujorshit të parë, gjysmëvjetorit të parë dhe tremujorshit të tretë.

Mësimdhënësit, gjatë kohës së jashtëzakonshme, notat e mësimit në distancë, përkatesisht mësimit nga shtëpia, në bazë të dispozitave ligjore i shënojnë edhe në ditarin elektronik.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Byroja e zhvillimit të arsimit dhe Qendra e arsimit profesional dhe trajnime në periudhën vijuese do të vazhdojnë me aktivitetet për plotësimin e udhëzimit në bazë të kushteve të krijuara.

МИНИСТЕР/MINISTËR,

Dr. Arbër Ademi